

Praktikat e Buxhetimit në Gjashtë Komuna të Kosovës

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA

boogapod



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

I. Contents

I. Hyrje	4
II. Aspektet teorike të buxhetimit	5
III. Procesi buxhetor - Korniza Ligjore	6
IV. Krahasimi i buxhetit të gjashtë komunave në periudhën 2010-2013	8
4.1 Buxheti i Prishtinës	8
4.2 Buxheti i Pejës	9
4.3 Buxheti i Gjakovës	10
4.4 Buxheti i Gjilanit	11
4.5 Buxheti i Ferizajit	12
4.6 Buxheti i Podujevës	13
4.7 Krahasimet	16
V. Buxhetimi në nivel lokal: sfidat, pengesat dhe mangësitë	22
VI. Transparenca	33
VII. Rekomandime të politikave	36

I. Hyrje

Në kuadër të qeverisjes lokale buxheti përfshinë një plan të përgjithshëm për arritjen e synimeve dhe objektivave të organizatave buxhetore. Procesi buxhetor ka të bëjë me ndarjen e resurseve (të pakta) për programet dhe shërbimet e caktuara, prandaj edhe konsiderohet si një nga aktivitetet më të rëndësishme të institucioneve qeverisëse. Një proces buxhetor i integruar mirë rezulton me vendime më të mira financiare, duke ndikuar kështu pozitivisht në funksionimin e përgjithshëm të institucionit. Në këtë drejtim, përfshirja e zyrtarëve të ndryshëm qeveritarë, punonjësve të organizatës buxhetore dhe të qytetarëve e publikut në përgjithësi, ndihmon në pasqyrimin e nevojave esenciale të hisedarëve në fushën e caktuar, kërkesave dhe prioriteteve të tyre, dhe para së gjithash ndikon në përmirësimin e përshtypjeve të publikut për institucionet e shtetit. Prandaj, synimi i kësaj Analize Politikash është të hedh dritë mbi sfidat kryesore dhe jo efikasitetin që haset në komunat e Kosovës gjatë përgatitjes dhe ekzekutimit të buxhetit. Më saktësisht, përmes intervistave të zhvilluara në gjashtë komunat kryesore të Republikës së Kosovës, kjo analizë synon të ekzaminoj procesin buxhetor në nivel komunal, parimet dhe kornizën ligjore, llojet e sistemeve buxhetore që përdoren nga institucionet e shtetit, krahasimin në mes të gjashtë komunave, prioritetet buxhetore komunale, kriteret për ndarjen e buxhetit, pjesëmarrjen e qytetarëve në takimet publike, nivelin e transparencës, nëse në këto komuna ka deficit apo suficit buxhetor dhe cilat janë arsyet për këtë.¹ Gjithashtu, ky studim do të propozoj rekomandimet e nevojshme për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e përgatitjes së buxhetit, rritjen e shkallës së transparencës nga komunat përmes publikimit të raporteve të detajuara financiare dhe sugjerime të tjera me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së transparencës në procesin e përgatitjes, ndarjes dhe ekzekutimit të buxhetit.

Për nga përmbajtja analiza është e strukturuar si vijon: kapitulli II ofron një përshkrim të shkurtër të aspekteve teorike rreth buxhetimit, duke përfshirë parimet dhe llojet e buxhetimit. Kapitulli III shtjellon kornizën ligjore të procesit buxhetor, më saktësisht përshkruan në detaje hapat që duhet ndërmarrë për të përgatitur dhe miratuar buxhetin. Kapitulli IV ofron të dhëna krahasuese për buxhetin e komunës së Prishtinës, Podujevës, Pejsës, Gjakovës, Gjilanit dhe Ferizajit, për katër vitet e fundit, duke përfshirë edhe shkallën e buxhetit për kokë banori në vitet 2011 dhe 2012. Kapitulli V përshkruan metodologjinë e përdorë për të vlerësuar punën dhe nivelin e transparencës në procesin e përgatitjes dhe ekzekutimit të buxhetit në nivel komunal. Përmes intervistave individuale me zyrtarë të komunave, analiza ofron informacione mbi prioritetet buxhetore të komunave, pjesëmarrjen e qytetarëve në hartimin e buxhetit, auditimin e brendshëm dhe të jashtëm dhe publikimin e raporteve financiare. Kapitulli VI shtjellon më tej transparencën e komunave dhe nëse ato kanë botuar rregullisht raportet financiare tremujore dhe vjetore siç kërkohet me ligj. Dhe në fund, kapitulli VII ofron rekomandimet konkrete për përmirësimin dhe rritjen e transparencës në procesin e përgatitjes, ndarjes dhe ekzekutimit të buxhetit.

¹ Asociacioni i Zyrtarëve Financiar Qeveritar. (1999). *Praktika e rekomanduar buxhetore: Kornizë për përmirësimin e buxhetimit në nivel qëndror dhe lokal*. Chicago. Këshilli Këshillues Kombëtar për Buxhetim në nivel Qendror dhe Lokal.

II. Aspektet teorike të buxhetimit

Buxheti në qeverisjen lokale paraqet planin financiar, i cili specifikon të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore. Përmes procesit buxhetor, institucionet në nivel lokal vlerësojnë nevojat e tyre kundrejt nivelit të buxhetit që kanë në dispozicion.² Në kuadër të buxhetit komunal përfshihet buxheti operacioanal dhe kapital. Buxheti operacional përfshinë planin aktual të shpenzimeve dhe mënyrën se si do të mbulohen ato shpenzime. Në anën tjetër buxheti kapital përfshinë planin afatgjatë të shpenzimeve për blerjen e asetëve dhe mënyrën se si ato shpenzime do të mbulohen.³ Edhe aktivitetet që ndërliken me zhvillimin, ekzekutimin dhe vlerësimin e planit për shërbimet dhe asetet janë pjesë e procesit buxhetor. Një karakteristikë e mirë e procesit buxhetor është edhe ndërtimi i vizionit të integruar afatgjatë, përqëndrimi në synimet e organizatës buxhetore, avancimi i komunikimit me hisedarët si dhe përfshirja e stimujve për motivimin e menaxhmentit dhe të punësuarve.⁴ Procesi buxhetor përfshinë një sërë parimesh të ndryshme që tregojnë se zhvillimi buxhetor, përveç aspekteve politike dhe financiare, ka të bëjë shumë edhe me aspektet teknike. Katër parimet kryesore të procesit buxhetor janë:⁵

- Përcaktimi i synimeve që ndihmojnë në vendimmarrje
- Zhvillimi i planeve, politikave, programeve dhe strategjive që ndihmojnë në arritjen e synimeve
- Përgatitja dhe miratimi i planit financiar të bazuar në fondet që janë në dispozicion
- Vlerësimi i rregullt i performances financiare, që inkurajon arritjen e synimeve

Siç u theksua më lartë, buxheti duhet hartuar në atë mënyrë që mundëson arritjen e synimeve të caktuara të bazuara në nevojat e institucionit. Kjo mund të arrihet në tri mënyra: nga lartë poshtë, nga poshtë lartë dhe përmes qasjeve buxhetore të negociimit. Qasja nga lartë poshtë, që njihet si qasje e imponuar, nënkupton që menaxhmenti i lartë e përgatit buxhetin për organizatën buxhetore pa u konsultuar me nivelet më të ulëta të menaxhmentit, dhe si i tillë u imponohen atyre që e ekzekutojnë atë. Qasja nga poshtë lartë njihet si qasje pjesëmarrëse, ku buxheti përgatitet nga nivelet më të ulëta të menaxhmentit, ku zyrtarët e djathtë më mirë se çka është e arritshme, dhe më pas i dorëzohet menaxhmentit të lartë. Një kombinim i këtyre dy qasjeve në procesin buxhetor njihet si stili i negociuar i buxhetimit, ku niveli i lartë dhe nivelet më të ulëta të menaxhmentit pajtohen rreth përmbajtjes së buxhetit duke negociuar atë çfarë menaxhmenti i lartë dëshiron të arrijë dhe çfarë menaxhmenti më i ulët vlerëson se është e arritshme.⁶

2 Departamenti i Oregonit për të Hyrat (X). Manual për buxhetim në nivel lokal. Shteti i Oregonit: Divizioni i Tatimit në Pronë.

3 DiNapoli, Th.P. (2010). Udhëzues për qytetarët rreth buxhetimit në nivel lokal. New York: Zyra e Divizionit të Kontrollit dhe LLogaridhënies në Shkollë, Shteti i New York.

4 Asociacioni i Zyrtarëve Financiar Qeveritar. (1999). Praktika e rekomanduara buxhetore: Kornizë për përmirësimin e buxhetimit në nivel qendror dhe lokal. Chicago. Këshilli Këshillues Kombëtar për Buxhetim në nivel Qendror dhe Lokal.

5 Asociacioni i Zyrtarëve Financiar Qeveritar. (1999). Praktika e rekomanduara buxhetore: Kornizë për përmirësimin e buxhetimit në nivel qendror dhe lokal. Chicago. Këshilli Këshillues Kombëtar për Buxhetim në nivel Qendror dhe Lokal.

6 ACCA, 2009. "Menaxhimi i Performancës". Londër: BPP Learning Media Ltd, BPP House. Mund ta gjeni në: <http://www.freeacca.blog.com/files/2010/06/F5-Study-Text-BPP.pdf>

III. Procesi buxhetor - Korniza Ligjore

Ligji Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përshkruan hapat e nevojshëm që duhet ndërmarr për zhvillimin dhe miratimin e buxhetit në nivel komunal, duke përfshirë edhe afatet kohore.⁷ Ky ligj është amandamentuar tri herë, në korrik të vitit 2010, në Qershor të vitit 2012 dhe në Korrik të vitit 2013 përmes Ligjit Nr.04/L-194.⁸ Hapat e detajuar që duhet ndërmarrë në përgatitjen dhe miratimin e buxhetit janë:

- **Hapi 1:** 30 Prill – Deri me 30 Prill të secilit vit, Qeveria duhet t’ia dorëzojë Kuvendit Kornizën Afat Mesme të Shpenzimeve (KAMSH) për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve ndër të tjera përfshinë, parashikimet dhe indikatorët ekonomik, prioritetet e politikave, parashikimin e të hyrave dhe planin buxhetor të shpenzimeve, KAMSH përmban, vlerësimin e investimeve kapitale dhe granteve për të gjitha komunat.⁹
- **Hapi 2:** 15 Maj - Ministri i Financave i dërgon qarkoren e parë buxhetore të gjithë Zyrtarëve Kryesor Financiar të të gjitha organizatave buxhetore. Qarkorja buxhetore ofron informacione dhe udhëzime në lidhje me tavanet e shpenzimeve dhe nivelin e shpenzimeve të përcaktuar me KAMSH, tërë procedurën për përgatitjen e buxhetit, formatin, afatet kohore dhe informacione të tjera të nevojshme.¹⁰
- **Hapi 3:** 1 Korrik - ZKF i komunës duhet, me ose para 1 Korrikut të vitit aktual kalendarik, t’i dërgojë kryesuesit të secilit departament komunal të komunës një qarkore buxhetore komunale me informata specifike mbi tavanet e shpenzimeve për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime për dy vitet e ardhshme fiskale, metodologjinë dhe formularët gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe afatet kohore. Pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar në qarkoren e brendshme buxhetore, ZKF duhet të shqyrtojë propozim-buxhetet dhe kërkesat për ndarje buxhetore të cilat janë të dorëzuara nga departamentet komunale, të mbajë takime me secilin departament me qëllim të vlerësimit të nevojave, problemeve dhe shqetësimeve të tyre. Pas dëgjimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore, ZKF duhet të përgatis dhe t’i dorëzojë Kryetarit të Komunës Buxhetin e Propozuar Komunal për vitin e ardhshëm fiskal dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale dhe njëkohësisht të shpërndaj atë të gjitha departamenteve komunale.¹¹

7 Ligji Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

8 Ligji Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji Nr. 04/L116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221 dhe Ligjin Nr. 04/L-116.

9 Ligji Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 19.

10 Ligji Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 20.2. Ligji Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 20.3

11 Ligji Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Nenet 60.1, 60.2, 60.3; Qarkorja Buxhetore 2013/01, Ministria e Financave, 10 Maj 2012

- **Hapi 4:** 15 Gusht - Nëse është e nevojshme, jo më vonë se me 15 Gusht, Ministri nxjerr qarkoren e dytë buxhetore me udhëzime shtesë dhe e shpërndan në të gjitha komunat dhe organizatat tjera buxhetore.¹²
- **Hapi 5:** 1 Shtator - Pas miratimit nga Kryetari i Komunës, Buxheti i Propozuar Komunal, dorëzohet për miratim në Kuvendin Komunal. Ky dokument përmban parashikimet ekonomike dhe buxhetore, parashikimet për të hyrat e përgjithshme, shpenzimet dhe mbështetjen e donatorëve, si dhe informacione të tjera relevante. Kuvendi Komunal duhet të organizoj dëgjime publike në përputhje me legjislacionin komunal.¹³
- **Hapi 6:** 30 Shtator - Pasi të kenë përfunduar dëgjimet publike, Kuvendi Komunal duhet të vlerësoj, ndryshoj, miratoj dhe të dorëzoj Buxhetin e Propozuar Komunal në Ministrinë e Financave, jo më vonë se me 30 Shtator.¹⁴

Kjo tregon që komunat dhe institucionet tjera përgatisin buxhetin e propozuar në bazë të nevojave të tyre, në përputhje me kufizimet që përcaktohen me qarkoret buxhetore për shumën e mjeteve që kërkohet, respektivisht tavanet buxhetore, ndërsa më pas buxheti i përgjithshëm shqyrtohet dhe miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Përveç procesit buxhetor, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal përcakton qartë burimet e të hyrave komunale. Sipas nenit 7 të këtij ligji: Burimet financiare të një komune përbëhen nga: a) të hyrat vetanake; b) grantet operative; c) grantet për kompetencat e shtuara; d) transferet për kompetencat e deleguara; e) grantet e jashtëzakonshme; f) ndihma financiare nga Republika e Serbisë; dhe g) të hyrat nga huamarrjet e komunës.¹⁵ Përderisa, detajet për secilën kategori mund të gjinden në Ligjin e lartpërmendur, përcaktuesit e grantit operacional do të shtjellohen me qëllim që të kuptohet më mirë analiza në vijim.

Granti operativ përbëhet nga: a) Granti i përgjithshëm: b) Granti specifik për arsim: dhe c) Granti specifik për shëndetësi. Qëllimi i grantit të përgjithshëm është të siguroj stabilitet financiar për komunën dhe të siguroj qasje të drejtë dhe të barabartë në shërbimet publike për të gjithë banorët e komunës. Secila komunë pranon një shumë fikse prej 140,000 € në vit, minus 1€ për kokë banori, ose 0€ për komunat me popullësi të barabartë ose më të madhe se 140,000. Pjesa e mbetur e grantit të përgjithshëm u alokohet komunave në përpjesëtim me: a) numrin e popullsisë: b) numrin e popullsisë pakicë: b) nëse shumica e popullsisë përbëhet nga pakica kombëtare; dhe c) madhësia gjeografike. Në anën tjetër, granti për arsim përcaktohet në përputhje me numrin e mësimdhënësve dhe numrin e nxënësve të regjistruar. Ndërsa, granti për shëndetësi përcaktohet në përputhje me moshën dhe gjininë e qytetarëve sipas regjistrave të institucioneve primare shëndetësore, si dhe numrin e të moshuarve me nevoja speciale shëndetësore.

12 Ligji Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 20.2. Ligji Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 20.3

13 Shqio Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Neni. 61, paragrafi 61.1, 62.2, 61.3

14 Qarkorja Buxhetore 2013/01, Ministria e Financave, 10 Maj 2012

15 Ligji Nr. 03/L-049 mbi Financat e Pushtetit Lokal. Nenet 7,24 dhe 25. Qasur me 25 Shkurt 2014, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_en.pdf

IV. Krahasimi i buxhetit të gjashtë komunave në periudhën 2010-2013

Ky kapitull pasqyron ndarjet buxhetore në gjashtë komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Gjiilan, Ferizaj dhe Podujevë) për katër vitet e fundit, respektivisht periudhën 2010-2013. Këtu përshkruhet buxheti i përgjithshëm i secilës komunë për secilin vit, përqindjen e secilës kategori buxhetore, krahasimin në mes të komunave dhe buxhetin për kokë banori për vitet 2011 dhe 2012. Buxheti i përgjithshëm ndahet në pesë kategori kryesore: 1) Paga dhe medijtje; 2) Mallra dhe Shërbime; 3) Shpenzime komunale; 4) Subvencione dhe transfere; dhe 5) Investime kapitale.

4.1 Buxheti i Prishtinës

Tabela 1. **Buxheti i Prishtinës**¹⁶

Viti		2010	2011	2012	2013
Shpenzimet	Paga dhe medijtje	16,534,009	21,208,663	22,048,920	22,179,999
	Mallra dhe shërbime	5,154,749	6,055,872	7,136,850	7,248,432
	Shpenzimet komunale	2,100,660	1,935,228	1,548,000	1,605,000
	Subvencionet dhe transferet	1,035,950	1,646,490	1,407,690	1,000,000
	Investimet kapitale	23,176,262	27,628,453	25,552,653	31,338,299
Burimet e fondit buxhetor	Grantet qeveritare	32,721,714	39,792,761	39,843,922	41,613,811
	Të hyrat vetanake për transfer	8,231,842	10,495,189	8,354,450	
	Të hyrat vetanake	7,044,793	7,965,460	9,335,688	21,757,920
	Donacionet vendore	3,281	145,182	102,365	
	Donacionet e huaja		76,114	57,688	
Buxheti i përgjithshëm		48,001,630	58,474,706	57,694,113	63,371,730

Përgjatë viteve, Komuna e Prishtinës ka pasur buxhetin më të madh. Në vitin 2010 buxheti i përgjithshëm ka qenë 48,001,630€, ndërkohë që 48% e buxhetit është ndarë për investime kapitale, ndërkohë pagat dhe medijtjet përbënin 34.43% të buxhetit. Pjesa e mbetur ndahej me 10.74% për mallra dhe shërbime, 4.38% për shpenzime komunale dhe 2.16% për subvencione dhe transfere. Në vitin 2011 buxheti i përgjithshëm ishte 58,474,706€, duke shënuar kështu rritje për rreth 22% në krahasim me vitin 2010. Rritja e buxhetit ishte rezultat i rritjes së granteve qeveritare për 22% dhe rritjes së të hyrave vetanake prej 27%. Këto dy burime përbënin 86% të të hyrave të përgjithshme.

¹⁶ Të dhënat në lidhje me të hyrat dhe shpenzimet e gjashtë komunave për vitet 2010-2012 të përfshira në këtë analizë janë siguruar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, ndërsa të dhënat për vitin 2013 janë marr nga Ligjin për Buxhetin 2013- Tabela 4.1

Megjithatë, në vitin 2012 buxheti i përgjithshëm i Komunës së Prishtinës shënoi rënie prej 1.34%. Zvogëlimi i buxheit ishte pasojë e rënies së shpenzimeve të të hyrave vetanake. Edhe pse shumica e përgjithshme e ndarë për investime kapitale shënoi rënie për rreth 8%, kjo kategori buxhetore përbënë përqindjen më të madhe të buxhetit të përgjithshëm apo 44.29%. Kategoria e dytë më e madhe në përqindje është ajo e pagave dhe mëditjeve, e cila shënoi rritje me 4% në vitin 2012, me gjithë faktin që buxheti i përgjithshëm shënoi rënie. Në vitin 2013 planifikohej rritja e buxhetit të përgjithshëm për rreth 10%, e që parashikonte rritje në kategoritë e investimeve kapitale, pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve, ndërsa zvogëlimin e buxhetit për subvencione dhe transfere.

4.2 Buxheti i Pejës

Tabela 2. **Buxheti i Pejës**

Viti		2010	2011	2012	2013
Shpenzimet	Paga dhe meditje	8,264,596	10,023,108	10,378,157	10,512,912
	Mallra dhe shërbime	1,327,423	2,009,956	2,686,923	2,343,763
	Shpenzimet komunale	505,754	500,349	557,083	591,914
	Subvencionet dhe transferet	286,867	328,432	473,692	350,000
	Investimet kapitale	5,204,202	5,877,008	4,874,583	5,853,728
Burimet e fondit buxhetor	Grantet qeveritare	12,479,355	15,690,539	15,930,094	16,752,317
	Të hyrat vetanake për transfer	705,886	765,294	668,228	
	Të hyrat vetanake	1,778,369	1,880,030	2,121,449	2,900,000
	Donacionet vendore	15,227	4,800	6,560	
	Donacionet e huaja	610,005	398,190	244,107	
Buxheti i përgjithshëm		15,588,842	18,738,853	18,970,438	19,652,317

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Pejës në vitin 2010 ishte 15,589,842€. Kategoria e pagave dhe mëditjeve përbënte gjysmën e buxhetit, ndërkohë që rreth 33% ishte ndarë për investime kapitale. Në vitin 2011, buxheti i komunës shënoi rritje për rreth 20%, si rezultat i rritjes së transfereve qeveritare për 26%. Transferet qeveritare përbënin 85% të të hyrave në buxhetin e përgjithshëm. Viti 2012 u karakterizua me rritje të lehtë të buxhetit të përgjithshëm, e që rezultoi me rritje të shpenzimeve për të gjitha kategoritë me përjashtim të investimeve kapitale. Rritja e buxhetit ishte rezultat i rritjes së transfereve qeveritare dhe të hyrave vetanake. Sërish, më shumë se 50% e buxhetit shpenzohej për paga dhe mëditje, dhe rreth 26% për investime kapitale. Në vitin 2013, buxheti i përgjithshëm i komunës shënoi rritje prej 4%, duke rritur sërish shpenzimet në kategorinë e pagave dhe mëditjeve si dhe investimeve kapitale.

4.3 Buxheti i Gjakovës

Tabela 3. Buxheti i Gjakovës

Viti	2010	2011	2012	2013	
Shpenzimet	Paga dhe medetje	7,688,222	9,785,772	10,196,103	10,216,359
	Mallra dhe shërbime	1,260,334	1,373,884	1,708,009	1,557,855
	Shpenzimet komunale	525,870	530,617	649,066	693,600
	Subvencionet dhe transferet	336,351	446,837	1,069,566	548,000
	Investimet kapitale	5,171,755	5,912,095	6,001,278	6,006,404
Burimet e fondit buxhetor	Grantet qeveritare	12,659,854	15,649,501	16,448,318	16,122,218
	Të hyrat vetanake për transfer	217,418	415,588	491,511	
	Të hyrat vetanake	2,011,341	1,894,746	2,449,266	2,900,000
	Donacionet vendore	75,680	43,288	199,222	
	Donacionet e huaja	18,239	46,082	35,705	
Buxheti i përgjithshëm	14,982,532	18,049,205	19,624,022	19,022,218	

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Gjakovës në vitin 2010 ishte 14,982,532€, duke shënuar rritje të vazhdueshme prej 20% në vitin 2011, 9% në vitin 2012 dhe rënie prej 3% në vitin 2013. Rritja e buxhetit në vitin 2011 ishte rezultat i rritjes së granteve qeveritare të cilat përbënin rreth 87% të të hyrave në buxhetin e komunës. Përqindja më e madhe e buxhetit ndahet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve, e cila ka shënuar rritje nga viti në vit dhe përbënte rreth 57% të buxhetit të përgjithshëm në vitin 2013. Investimet kapitale përbënin rreth 35% të buxhetit të përgjithshëm, përqindje kjo që shënoi rënie përgjatë viteve. Për periudhën 2010-2013 kategoria e mallrave dhe shërbimeve përbënte mesatarisht 8% të shpenzimeve buxhetore, ndërsa subvencionet dhe transferet përbënin rreth 3% të buxhetit të përgjithshëm.

4.4 Buxheti i Gjilanit

Tabela 4. Buxheti i Gjilanit

Viti		2010	2011	2012	2013
Shpenzimet	Paga dhe medetje	9,114,466	11,084,916	11,508,281	11,529,100
	Mallra dhe shërbime	1,995,809	2,102,812	2,546,755	2,804,919
	Shpenzimet komunale	499,372	399,522	380,099	481,580
	Subvencionet dhe transferet	500,342	270,195	283,372	562,500
	Investimet kapitale	7,126,451	5,390,262	4,042,439	3,040,583
	Grantet qeveritare	15,799,190	15,605,348	15,319,536	14,818,682
Burimet e fondit buxhetor	Të hyrat vetanake për transfer		436,660	402,198	
	Të hyrat vetanake	3,003,806	3,145,344	2,966,741	3,600,000
	Donacionet vendore	74,270	12,870	18,481	
	Donacionet e huaja	359,174	47,484	53,990	
Buxheti i përgjithshëm		19,236,440	19,247,707	18,760,946	18,418,682

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Gjilanit në vitin 2010 ishte 19,236,440€. Përqindja më e madhe e buxhetit, apo 47.38% ndahej për kategorinë e pagave dhe mëditjeve, ndërsa 37.5% për mallra dhe shërbime. Vitin vijues buxheti i përgjithshëm mbeti pothuajse i njëjtë, ndërkohë që në vitin 2012 shënoi rritje prej 3%, e më pas në vitin 2013 sërish shënoi rënie prej 2%. Me gjithë zvogëlimet në buxhetin e përgjithshëm, në të gjitha kategoritë buxhetore, me përjashtim të investimeve kapitale, kishte rritje të shpenzimeve. Investimet kapitale në dy vitet e fundit shënuan rënie rreth 25%. Vlen të theksohet se derisa në vitin 2010 pagat dhe mëditjet përbënin 47% të buxhetit të përgjithshëm, në vitin 2013 kjo kategori buxhetore përbënte 63% të buxhetit të përgjithshëm. Në anën tjetër investimet kapitale në vitin 2010 përbënin 37% të buxhetit të përgjithshëm, ndërsa në vitin 2013 vetëm 17%.

4.5 Buxheti i Ferizajit

Tabela 5. Buxheti i Ferizajit

Viti		2010	2011	2012	2013
Shpenzimet	Paga dhe medetje	8,142,904	10,346,562	11,036,125	11,084,100
	Mallra dhe shërbime	1,268,029	1,429,692	2,083,285	1,724,658
	Shpenzimet komunale	471,272	507,534	327,369	373,550
	Subvencionet dhe transferet	542,222	578,467	573,404	635,000
	Investimet kapitale	6,127,113	6,985,811	6,687,940	6,932,954
	Grantet qeveritare	13,312,288	16,316,583	16,914,529	17,124,262
Burimet e fondit buxhetor	Të hyrat vetanake për transfer	812,312	851,700	965,470	
	Të hyrat vetanake	2,208,732	2,411,491	2,336,293	3,626,000
	Donacionet vendore	137,415	199,600	245,341	
	Donacionet e huaja	80,793	68,692	246,490	
Buxheti i përgjithshëm		16,551,540	19,848,066	20,708,123	20,750,262

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Ferizajit në vitin 2010 ishte 16,551,540€, duke shënuar rritje prej 20% në vitin 2011, 4% në vitin 2012 dhe rënie me 0.2% në vitin 2013. Përqindja më e madhe e buxhetit apo 52.03% ndahej për kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Investimet kapitale përbënin kategorinë e dytë më të madhe buxhetore me një mesatare prej 34.49% përgjatë periudhës katër vjeçare. Për këtë periudhë mesatarisht 8.27% e buxhetit ishte ndarë për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, 2.20% për shpenzimet komunale dhe 3% për subvencionet dhe transferet.


4.6 Buxheti i Podujevës

Tabela 6. Buxheti i Podujevës


Viti		2010	2011	2012	2013
Shpenzimet	Paga dhe medetje	6,740,075	8,679,102	9,005,424	9,051,827.00
	Mallra dhe shërbime	888,858	933,568	1,014,569	1,097,812
	Shpenzimet komunale	290,989	291,759	283,575	305,000
	Subvencionet dhe transferet	166,386	123,949	144,316	325,000
	Investimet kapitale	5,541,886	5,880,661	6,126,953	5,741,710
Burimet e fondit buxhetor	Grantet qeveritare	12,364,008	14,681,146	15,261,145	15,171,350
	Të hyrat vetanake për transfer	348,189	326,875	241,008	
	Të hyrat vetanake	774,818	768,933	908,441	1,350,000
	Donacionet vendore	141,179	7,000	604	
	Donacionet e huaja		125,085	163,639	
Buxheti i përgjithshëm		13,628,194	15,909,039	16,574,837	16,521,349

Në vitin 2010 buxheti i përgjithshëm i Komunës së Podujevës ishte 13,628,194€, duke shënuar rritje prej 16% në vitin 2011, 4% në vitin 2012 dhe rënie minimale prej 0.32% në vitin 2013. Përqindja më e madhe e buxhetit për periudhën katër vjeçare 2010-2013 ishte ndarë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve, respektivisht 49.46%, 54.55%, 54.33%, dhe 54.79%. Investimet kapitale përbënin kategorinë e dytë më të madhe buxhetore me 40.66%, 36.96%, 36.97%, dhe 34.75% për periudhën katër vjeçare. Pjesa e mbetur e buxhetit prej rreth 10% e vlerës së përgjithshme ishte ndarë për mallra dhe shërbime (6.52%, 5.87%, 6.12%, 6.64%), shpenzime komunale (2.11%, 1.83%, 1.71%, 1.85%), dhe subvencione e transfere (1.21%, 0.78%, 0.87%, 1.97%). Në krahasim me pesë komunat tjera, Komuna e Podujevës ka pjesëmarrjen më të lartë të granteve qeveritare në burimin e të hyrave. Përderisa në nivel të vendit, grantet qeveritare përbëjnë rreth 83% të buxhetit të komunave, grante qeveritare në vitin 2013 në Podujevë përbënin 92.% të buxhetit të përgjithshëm.


Buxheti i Prishtinës




Buxheti i Pejës




Buxheti i Gjilanit



Buxheti i Gjakovës



Buxheti i Ferizajit



≈ 1.000.000

Shpenzimet

- Paga dhe meditje
- Mallra dhe shërbimet
- Shpenzimet komunale
- Subvencionet dhe transferet
- Investimet kapitale

Burimet e Fondit Buxhetor

- Grantet qeveritare
- Të hyrat vetanake për transfer
- Të hyrat vetanake

Figura 1. Krahasimi i buxhetit të gjashtë komunave në periudhën 2010-2013

4.7 Krahasimet

Për vitet 2011-2012¹⁷ buxheti për kokë banori në K. e Prishtinës ishte 289.76€, respektivisht 282.57€, ndërkohë që në komunat tjera ishte më i vogël. Më saktësisht, buxheti i Pejës për kokë banori në vitet 2011 dhe 2012 ishte 192.47€, respektivisht 193.11€, në Gjakovë 189.27€, respektivisht 201.27€, në Gjilan 211.83€, respektivisht 205.23€, në Ferizaj 180.60€, respektivisht 186.32€ dhe në Podujevë 179€, respektivisht 185.84€. Kjo tregon që Prishtina ka buxhetin më të madh për kokë banori, e ndjekur nga Gjilani, Gjakova, Peja, Ferizaji dhe Podujeva që ka buxhetin më të vogël për kokë banori. Në krahasim me Pejën, Prishtina ka pasur buxhet më të madh për kokë banori për 50.55%, respektivisht 46.33% në vitin 2012, në krahasim me Gjakovën 53.09% dhe 38.33%, në krahasim me Gjilantin 36.79% dhe 37.68%, në krahasim me Ferizajn 60.44% dhe 51.66%, dhe në krahasim me Podujevën 61.88% dhe 52.04%.¹⁸

Siç shihet nga të dhënat, vetëm komuna e Prishtinës ka ndarë pjesën më të madhe të buxhetit për investime kapitale, ndërsa të gjitha komunat tjera kanë ndarë pjesën më të madhe të buxhetit për paga dhe mëditje. Në krahasim me buxhetin e përgjithshëm të Pejës, kategoria buxhetore për paga dhe mëditje në Prishtinë ka qenë mesatarisht 33% më e vogël për periudhën katër vjeçare. Sa i përket investimeve kapitale, përqindja e buxhetit e ndarë për këtë kategori në komunën e Prishtinës është rreth 59% më e madhe në krahasim me komunën e Pejës. Në krahasim me komunën e Gjakovës, pjesa e buxhetit e ndarë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve në komunën e Prishtinës është 31.81% më e vogël, ndërsa për kategorinë e investimeve kapitale mesatarisht 46.39% më e lartë për periudhën katër vjeçare. Përqindja e buxhetit të ndarë nga komuna e Prishtinës për paga dhe mëditje në vitet 2010, 2011 dhe 2012, në krahasim me komunën e Gjilanit, Ferizajit dhe Podujevës, është më e vogël për 37%, respektivisht 31%, dhe 32%. Në anën tjetër, në krahasim me komunat e njejta, përqindja mesatare e buxhetit e ndarë për investime kapitale është 100.78%, respektivisht 37% dhe 27% më e lartë për periudhën katër vjeçare.

Siç mund të shohim në tabelën më poshtë, Prishtina është komuna me përqindjen më të lartë të të hyrave vetanake në buxhetin e përgjithshëm (40% në vitin 2012), ndërsa Podujeva komuna me përqindjen më të ulët (me një mesatare prej 7% në tri vitet e fundit). Gjithashtu, komuna e Prishtinës vazhdimisht ka pasur rritje në të hyrat vetanake, duke arritur kulmin në vitin 2012, me një rritje prej 22%. Derisa në vitin 2010 Prishtina kishte 16.1 milion euro të hyra vetanake të transferueshme, në vitin 2012 kjo shumë u rrit në 21.3 milion euro, apo 33%. Me fjalë të tjera, në vitin 2012 të hyrat vetanake të transferueshme përbënin 37% të buxhetit të përgjithshëm. Kjo e bënë Prishtinën komunën me përqindjen më të madhe të të hyrave vetanake të transferueshme. Opozita thekson se arsyeje për këtë janë procedurat e tenderimit dhe vonesat në ekzekutimin e pagesave. Drejtori i Departamentit të Buxhetit dhe Financave, shpjegon se nuk kemi të bëjmë me suficit buxhetor, sepse kompanitë janë kontraktuar në përputhje me procedurat e prokurimit (sipas çmimit më të favorshëm)

¹⁷ Për shkak të mungesës së të dhënave rreth numrit të banorëve për periudhën 2010 dhe 2013, është analizuar vetëm viti 2011 dhe 2012.

¹⁸ Për më shumë shikoni tabelën 7. Buxheti për kokë banore për të gjashtë komunat në periudhën 2011 dhe 2012.



për projekte të caktuara që realizohen për periudha më të gjata. Megjithatë, sipas tij 'kompanitë nuk kanë pasur kapacitetet e nevojshme për kryerjen e punëve në kohën e paraparë, andaj komuna nuk ka ekzekutuar pagesat'.¹⁹ Të dhënat tregojnë se nga 21,326,799€ të cilat do të barten për vitin e ardhshëm, 16,846,466€ janë fonde të zotuara, e që tregon se vetëm 4,480,333€ nuk janë kontraktuar gjatë vitit 2012. Edhe partitë në pushtet edhe ato opozitare theksojnë se ekzistojnë probleme në procedurat e prokurimit dhe se ligji duhet të ndryshohet sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Sa i përket komunave tjera, me përjashtim të Pejës e cila ka pasur trende të rritjes së të hyrave vetanake të transferueshme në vitin 2012, në të gjitha komunat tjera ka pasur rënie të të hyrave vetanake të tranferueshme.²⁰

19 Bekteshi, Xh. "Procesi buxhetor në Komunën e Prishtinës". [Intervistë] 13 Janar 2014

20 Ministria e Financave. Raporti vjetor financiar. – Buxheti i Republikës së Kosovës. 31 Dhjetor, 2012. Qasur me 5 Shkurt, 2014., http://mf.rks-gov.net/Portals/0/Raporte%20dhe%20publikime/Raportet%20dhe%20Pasqyrat%20Financiare/Pasqyrat%20Financiare%202012_Eng.pdf

Figura 2. Përqindja e të hyrave vetanake dhe të hyrave vetanake të transferueshme në buxhetin e përgjithshëm të komunave



Një aspekt tjetër i rëndësishëm në menaxhimin e financave të pushtetit lokal është edhe niveli i borxheve të papaguara. Neni 39.1 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë specifikon se “ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.²¹ Megjithatë në komunat si ajo e Gjilanit, niveli i borxheve të papaguara arrinë deri në 18% të buxhetit të përgjithshëm të komunës. Në vitin 2012, niveli i borxheve të papaguara në komunën e Pejës dhe Gjakovës ishte ekuivalent me 4% të buxhetit të përgjithshëm. Prishtina është komuna me nivelin më të vogël të borxheve të papaguara, që kapin vlerën ekuivalent me 1% të buxhetit të përgjithshëm të komunës.

Figura 3. **Borxhet e papaguara**



21 Ligji Nr. 03/ L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 39.1 Qasur me 4 Shkurt 2014 , http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L048_en.pdf

Tabela 7. **Buxheti për kokë banori për gjashtë komunat 2011-2012**

Peja			
Seksioni	2011	2012	Rritja/ rënia nga 2011
Buxheti i përgjithshëm	18,741,000	18,970,438,25	1.22 ↑
Numri i banorëve	97,360	98,237	0.90 ↑
Buxheti për kokë banori	192.49	193.11	0.32 ↑

Podujeva			
Seksioni	2011	2012	Rritja/ rënia nga 2011
Buxheti i përgjithshëm	15,909,039.25	16,574,568.14	4.18 ↑
Numri i banorëve	88,877	89,185	0.35 ↑
Buxheti për kokë banori	179,00	185.84	3.82 ↑

Gjakova			
Seksioni	2011	2012	Rritja/ rënia nga 2011
Buxheti i përgjithshëm	18,049,205.73	19,624,022.11	8.73 ↑
Numri i banorëve	95,363	96,071	0.74 ↑
Buxheti për kokë banori	189.27	204,27	7.93 ↑

Prishtina			
Seksioni	2011	2012	Rritja/ rënia nga 2011
Buxheti i përgjithshëm	58,475,000	58,475,000	-1.34 ↓
Numri i banorëve	201,804	205,133	1.65 ↑
Buxheti për kokë banori	289.76	281.24	-2.94 ↓

Ferizaji			
Seksioni	2011	2012	Rritja/ rënia nga 2011
Buxheti i përgjithshëm	19,847,000	20,708,000	4.34 ↑
Numri i banorëve	109,899	111,141	1.13 ↑
Buxheti për kokë banori	180,59	186.32	3.17 ↑

Gjilani			
Seksioni	2011	2012	Rritja/ rënia nga 2011
Buxheti i përgjithshëm	19,247,705.96	18,760,946.26	-2.53 ↓
Numri i banorëve	90,863	91,413	0.61 ↑
Buxheti për kokë banori	211.83	205.23	-3.12 ↓

Burimi: Adaptuar nga autori në bazë të dhënave të siguruar nga Instituti GAP dhe Agjencioni Kosovari i Statistikave

V. Buxhetimi në nivel lokal: sfidat, pengesat dhe mangësitë

Ky kapitull ofron një pasqyrë më të thellë të buxhetit të këtyre gjashtë komunave, duke përfshirë ndër të tjera prioritetet e tyre, auditimin e brendshëm, mbikëqyrjen e zbatimit të buxhetit, përgatitjen e buxhetit dhe adresimin e nevojave të qytetarëve, pjesëmarrjen e qytetarëve në takimet publike që zhvillohen gjatë procesit buxhetor, shpërndarjen e buxhetit, deficitin dhe/ose suficitin buxhetor dhe arsytet që kanë shkaktuar atë. Me qëllim që të kuptojmë më qartë aspektet e procesit buxhetor të përmendura më lartë ne kemi zhvilluar takime dhe intervista individuale me Drejtorët e Departamenteve të Buxhetit dhe Financave ose Zyrtarët Kryesor Financiar si dhe takime me së paku një përfaqësues nga radhët e opozitës në komunat e Podujevës, Pejës, Gjakovës, Ferizajit, Gjilanit dhe Prishtinës.

Komuna e Podujevës

Komuna e Podujevës fillon përgatitjen e buxhetit dhe planit zhvillimor në bazë të limiteve të përcaktuara me qarkoren e parë buxhetore. Fillimisht, buxheti ndahet për Administratën e Komunës, Departamentin e Edukimit dhe Departamentin e Shëndetësisë. Të gjitha departamentet tjera përfshihen në kuadër të Administratës së Komunës. Departamentet e Edukimit dhe Shëndetësisë të ndara sepse atyre u ndahen grante specifike qeveritare të cilat nuk mund të transferohen në departamentet tjera, por mund të pranojnë fonde nga kategoritë tjera ekonomike. Zyrtari Kryesor Financiar e përgatit qarkoren e parë të brendshme e cila përfshinë kërkesat e detajuara për përgatitjen e buxhetit. Më pas zhvillohet një takim me bordin e drejtorëve, ku edhe finalizohet qarkorja e dytë buxhetore. Si rezultat përgatitet Korniza Afatmesme Buxhetore dhe zhvillohen takimet publike me qytetarë.²² Qarkorja e dytë buxhetore mundëson vazhdimin e hartimit të kornizës buxhetore për tri vitet në vijim dhe më pas dorëzohet në Kuvendin Komunal për miratim.²³ Buxheti miratohet me shumicën e thjeshtë të votave dhe herën e fundit që është miratuar buxheti edhe opozita ka qëndruar në mbledhje. Komuna ka vendosur të ketë gjashtë prioritetet buxhetore ku përfshihen: 1) krijimi i një ambienti të përshtatshëm për biznes, 2) zhvillimi i bujqësisë, 3) planifikimi hapësinor dhe zhvillimi urban, 4) përmirësimi i infrastrukturës, 5) përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale dhe 6) siguria dhe rritja e cilësisë së arsimit.

Gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit qytetarët marrin pjesë në takimet publike. Gjatë përgatitjeve për buxhetin e vitit 2014 janë zhvilluar 12 takime me qytetarë (10 nga të cilat janë zhvilluar në bashkëpunim me OSBE-në).²⁴ Takimet publike janë zhvilluar në vende të ndryshme, por vetëm dy nga anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa kanë marrë pjesë, ndërkohë që opozita nuk është ftuar të marrë pjesë në këto takime. Edhe pse këto takime janë zhvilluar, ato nuk mjaftojnë dhe duhet organizuar më shumë takime.²⁵ Sipas opozitës, prioritetet buxhetore janë në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe shumica e tyre janë realizuar me përjashtim të rregullimit të disa rrugicave.²⁶ Sa i përket ndarjeve buxhetore theksohet se buxheti ka mbuluar tërë territorin e komunës.²⁷ Megjithatë, opozita nuk pajtohet me këtë qëndrim ngase sipas tyre fshati Orllan mbetet tërësisht i përjashtuar nga ndarjet buxhetore, ngase përveç disa investimeve të vogla në rrugë nuk është investuar në ujësjellës dhe kanalizim.²⁸

Për më tepër, komuna e Podujevës ka pranuar donacione nga Komisioni Evropian që nga viti 2012, për renovimin e tri shkollave dhe ndërtimin e ndërtesës së komunës. Këto fonde janë monitoruar nga Komisioni Evropian dhe deri më tani nuk ekziston ndonjë raport në lidhje me performancën e investimeve nga donatorët.²⁹ Sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, në komunën e Podujevës mekanizmat e kontrollit gjatë prokurimit dhe

22 Latifi, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013

23 Latifi, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013

24 Latifi, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013

25 Abdullahu, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013

26 Abdullahu, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013

27 Latifi, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013

28 Abdullahu, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013

29 Abdullahu, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013

menaxhimit të kontratave nuk funksionojnë në disa nivele.³⁰ Sa i përket mbikëqyrjes së ekzekutimit të buxhetit dhe auditimit të brendshëm ekziston mospajtim në qëndrimet e Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe përfaqësuesve të opozitës. Në Drejtori, pohojnë se komuna vazhdimisht mbikëqyret nga Ministria e Financave dhe nga vet Kryetari i Komunës ndërkohë që raportet tre mujore dhe raport vjetore për shpenzimet dhe të hyrat përgatiten dhe vihen në dispozicion edhe përmes web faqes së komunës. Sipas tyre, gjithçka kryhet në bazë të rregulloreve për ekzekutimin e buxhetit, dhe se auditimi i brendshëm bëhet në baza tre mujore dhe vjetore.³¹ Në anën tjetër përfaqësuesit e opozitës thonë se komuna mbikëqyret vetëm nga Auditori i Përgjithshëm dhe se auditori i brendshëm asnjëherë nuk ka dorëzuar ndonjë raport tek përfaqësuesit e opozitës.³² Në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm pohojnë se plani i auditimit të brendshëm ka qenë shumë ambicioz, por nevojat e menaxhmentit të komunës janë plotësuar vetëm deri në një masë të caktuar.³³

Për më tepër në këtë komunë ka pasur vazhdimisht deficit apo suficit buxhetor. Suficiti është shkaktuar si pasojë e mos shfrytëzimit të mjeteve/parave pamundësisë për të procesuar të hyrat e Nëntorit dhe Dhjetorit në vitin aktual, si dhe mos ekzekutimit të vendimit për rritjen e koeficientit të pagës për të punësuarit në institucionet komunale. Vonesat në prokurim, joefikasiteti dhe nevoja e transferimit të mjeteve nga njëri vit në tjetrin sepse kontratat janë nënshkruar në muajt Nëntor apo Dhjetor, radhiten si faktorë të tjerë që shkaktojnë suficit. Në anën tjetër deficitit shkaktohet si pasojë e borxheve në kontratat dy apo tre vjeçare, dhe faktit se të hyrat e muajit Nëntor dhe Dhjetor nuk mund të përdoren në vitin aktual.³⁴

Komuna e Gjakovës

Procesi i buxhetimit në komunën e Gjakovës zhvillohet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Sa i përket procesit të buxhetimit për vitin 2013, për shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit është zhvilluar vetëm një takim i Kuvendit Komunal dhe i Komitetit për Politikë dhe Financa.³⁵ Plani zhvillimor i komunës ishte hartuar në vitin 2005 dhe prioritetet kryesore janë të përqendruara në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, bujqësi, kulturë dhe sport.³⁶ Opozita thekson se plani zhvillimor ka pësuar ndryshime në disa objektiva, dhe deri më tani nuk është realizuar, së paku jo në disa rajone si për shembull Hasi (i cili ka

30 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i auditimit për deklaratat financiare të komunës së Podujevës. 31 Dhjetor, 2012. Qasur me 30 Januar 2014,

http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPD_2012_Eng_735712.pdf

31 Latifi, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013

32 Neni 7.3 i Udhëzimit Administrativ Nr.23/2009 për Themelimin dhe Funkcionimin e Njësiave për Auditim të Brendshëm në Sektorin Publik specifikon që "Menaxhmenti i lartë, Komisioni për Auditim dhe Njësia Qëndrore e Hamornizimit për Auditim të Brendshëm duhet të pranojnë raporte tremujore dhe vjetore për aktivitetet e secilës Njësi për Auditim të Brendshëm. Raportet dorëzohen nga Drejtori i Njesisë për Auditim të Brendshëm."

33 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raporti i Auditimit i deklaratave financiare për Komunën e Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012, qasur më 30 Janar 2014,

http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPD_2012_Eng_735712.pdf

34 Latifi, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013; Abdullahu, I. "Procesi buxhetor në komunën e Podujevës". [Intervistë] 24 Tetor, 2013.

35 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Procesi i Zhvillimit të Buxhetit Komunal në Kosovë: Vlerësim i përgjithshëm për vitet 2012-2013. Qasur me 30 Januar 2013,

<http://www.osce.org/kosovo/102215>

36 Uka, Xh. "Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës". [Intervistë] 18 Dhjetor 2013

qenë i përfshirë në kuadër të planit por që nuk është vënë në zbatim). Kryetari i Komunës dhe Bordi i Drejtorëve kanë caktuar prioritetet buxhetore me qëllim të adresimit të nevojave të qytetarëve, por megjithatë shumica e këtyre prioritetëve nuk janë realizuar siç është rasti me ujin e pijshëm, ku rreth 50% e fshatrave të komunës nuk kanë ujë të pijshëm, pastaj në fushën e punësimit ka pasur pak progres dhe numri i vendeve të krijuara të punës është i vogël, ndërkohë që projekti për rindërtimin e Qarshisë është shoqëruar me shumë shkelje administrative dhe ligjore. Si pasojë, komuna e Gjakovës ka dështuar në adresimin e prioritetëve të planit zhvillimor në planin për ekzekutimin e buxhetit.³⁷

Me qëllim që qytetarët të kenë mundësi të shpalosin kërkesat dhe shqetësimet e tyre gjatë procesit buxhetor janë zhvilluar takime publike me qytetarë. Komuna e Gjakovës ka krijuar kushtet për pjesëmarrjen e qytetarëve në takimet e Kuvendit Komunal dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa kur diskutohet buxheti, por nuk ka publikuar njoftimin së paku shtatë ditë pune me herët.³⁸ Sa i përket buxhetit të vitit 2012, janë zhvilluar gjashtë takime publike me qytetarë, ndërsa për buxhetin e vitit 2013 janë mbajtur vetëm dy takime.³⁹ Në procesin e përgatitjes së buxhetit për vitin 2013, një nga takimet publike me qytetarë është mbajtur jashtë ndërtesës së komunës, gjë që shënon një hap pozitiv ngase mundëson pjesëmarrjen më të madhe të qytetarëve.⁴⁰ Gjatë këtyre takimeve qytetarët kanë parashtruar kërkesat e tyre në lidhje me punësimin, arsimin, infrastrukturën, kushtet socio-ekonomike, ndërkohë që ankesat kryesore kanë qenë për mospërfshirjen e disa rajoneve në projekte të caktuara.⁴¹ Sipas përfaqësuesve të opozitës, takimet publike me qytetarë janë zhvilluar “sa për sy e faqe” dhe se numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë në takime ka qenë shumë i vogël. Zakonisht takimet janë zhvilluar gjatë periudhave zgjedhore dhe për interesat e partive në pushtet. Kërkesat e parashtruara nga qytetarët nuk janë përmbushur në shumicën e rasteve. Sektori i arsimit në komunën e Gjakovës është i politizuar. Ministria e Arsimit ka kërkuar që të avancohet arsimi parashkollor, po në vend të kësaj janë punësuar njerëz në shkollat fillore dhe të mesme, dhe pagat e tyre janë mbuluar me mjetet që kanë qenë të destinuara për arsimin parashkollor. Pjesa më e madhe e projekteve të investimeve kapitale në fushën e arsimit nuk është realizuar, ndërkohë që ato që janë realizuar kanë qenë të ndikuara politikisht, dhe janë karakterizuar me nepotizëm politik.⁴²

Për shkak të buxhetit të vogël që i ndahet kësaj komune, jo të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe të rajoneve të caktuara janë përfshirë me rastin e ndarjes së buxhetit.⁴³ Sipas përfaqësuesve të opozitës pjesa më e madhe e buxhetit është ndarë në zonat të cilat janë me interes për partinë në pushtet, respektivisht zonat ku ata kanë numrin më të madh të votave. Andaj, ndarjet buxhetore nuk bëhen në bazë të kritereve kredibile por

37 Gola, L. “Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës”. [Intervistë] 18 Dhjetor 2013

38 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Procesi i Zhvillimit të Buxhetit Komunal në Kosovë: Vlerësim i përgjithshëm për vitet 2012-2013. Qasur me 30 Januar 2013, <http://www.osce.org/kosovo/102215>

39 Uka, Xh. “Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës”. [Intervistë] 18 Dhjetor 2013

40 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Procesi i Zhvillimit të Buxhetit Komunal në Kosovë: Vlerësim i përgjithshëm për vitet 2012-2013. Qasur me 30 Januar 2013, <http://www.osce.org/kosovo/102215>

41 Uka, Xh. “Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës”. [Intervistë] 18 Dhjetor 2013

42 Gola, L. “Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës”. [Intervistë] 18 Dhjetor 2013

43 Uka, Xh. “Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës”. [Intervistë] 18 Dhjetor 2013

në bazë interesave politike të partisë në pushtet.⁴⁴ Sa i përket mbikëqyrjes së procedurave për ekzekutimin e buxhetit, Drejtori i Sektorit të Buxhetit pohon se mbikëqyrja ka qenë e vazhdueshme nga Drejtori për Buxhet dhe Financa dhe vazhdimisht janë përgatitur raporte për shpenzimet siç parashihet me rregulloret e thesarit. Në anën tjetër përfaqësuesit e opozitës theksojnë se edhe mbikëqyrja e shpenzimit të buxhetit nuk është bërë si duhet, dhe se mjafton të shihet projekti për rindërtimin e Qarshisë ku: shkeljet, pjesët e papërfunduara dhe cilësia e dobët e punëve të kryera janë evidente. Prandaj, ata vlerësojnë se mbikëqyrja e shpenzimit të parasë nuk është bërë në përputhje me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve.⁴⁵ Problemet me ekzekutimin e kontratave janë identifikuar edhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, ku është konkluzuar se mekanizmat e kontrollit janë të pamjaftueshëm.⁴⁶

Për secilën komunë dhe organizatë buxhetore auditimi i brendshëm dhe i jashtëm është element shumë i rëndësishëm dhe ndikon në rritjen e transparencës. Komuna e Gjakovës vazhdon ta ketë të punësuar vetëm një auditor të brendshëm, ndërkohë që udhëzimi administrativ specifikon qartë se të gjitha organizatat buxhetore në sektorin publik që kanë buxhet më të lartë se 5 milion euro, duhet të kenë së paku tre auditor të brendshëm.⁴⁷ Megjithatë, auditimi i brendshëm është kryer vazhdimisht por nuk ka qenë efikas sepse nuk ka arritur të mbulojë sektorët më të ndjeshëm si prokurimi.⁴⁸ Raportet e auditimit të brendshëm nuk kanë qenë të kompletuar sepse jo gjithçka është pasqyruar aty siç duhet në lidhje me ndarjet buxhetore për projektet kapitale, procesin e pagesave e kështu me radhë. Ky konkluzion mbështet edhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.⁴⁹ Gjithashtu, sa i përket tenderëve, kjo komunë pasqyron shembullin tipik të keqmenaxhimit sepse pa pasur fondet e zotuara, kanë shpallur tenderë dhe kompanitë fituese kanë nisur punën me shumën fillestare në vlerën e 10% të shumës së përgjithshme të paraparë me kontratë. Megjithatë, kompanitë kanë kryer më shumë se 10% të punës ë paraparë, ndërkohë që pagesat nuk janë kryer, gjë që ka rritur kështu borxhin e përgjithshëm në 5 deri 8 milion euro gjatë tri viteve të fundit. Komuna është përballur me deficit buxhetor, dhe nuk është treguar transparente në publikimin e të dhënave financiare.⁵⁰

44 Gola, L. "Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës". [Intervistë] 18 Dhjetor 2013

45 Uka, Xh. "Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës". [Intervistë] 18 Dhjetor 2013 and Gola, L. "Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës". [Intervistë] 18 Dhjetor 2013

46 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i auditimit për deklaratat financiare të komunës së Gjakovës. 31 Dhjetor, 2012. Qasur me 30 Janar 2014 2014, http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGJ_2012_Eng_761546.pdf

47 Udhëzimi Administrativ Nr.23/2009 për Themelimin dhe Funksionimin e Njësive për Auditim të Brendshëm në Sektorin Publik. Neni 3

48 "Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës". [Intervistë] 18 Dhjetor 2013

49 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i auditimit për deklaratat financiare të komunës së Gjakovës. 31 Dhjetor, 2012. Qasur me 30 Janar 2014 2014

http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGJ_2012_Eng_761546.pdf

50 Gola, L. "Procesi buxhetor në komunën e Gjakovës". [Intervistë] 18 Dhjetor 2013

Komuna e Pejës

Procesi buxhetor në komunën e Pejës zhvillohet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Plani zhvillimor i komunës është hartuar në vitin 2007 në bashkëpunim me një organizatë Holandeze e cila synon të ndihmoj në shëndrrimin e Pejës në një qytet të gjelbërt dhe vital. Prioritet e përfshira në planin zhvillimor janë të orientuara drejt zhvillimit të turizmit, bujqësisë, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës rrugore, ujësjellësin dhe kanalizimin, në përputhje me kërkesat e qytetarëve që parashtrihen në baza vjetore.⁵¹ Gjatë procesit të zhvillimit të buxhetit organizohen pesë takime publike me qytetarë, ku parashtrihen kërkesat dhe shqetësimet e tyre e që zakonisht kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe ndarjen jo të drejtë të buxhetit në disa fshatra dhe lagje të caktuara.⁵² Në lidhje me buxhetin janë zhvilluar dy takime dhe shumica e pjesëmarrësve kanë qenë elektorat i partisë në pushtet (AAK), andaj shqetësimet e qytetarëve nuk janë pasqyruar si duhet në buxhet.⁵³ Të gjeturat e OSBE tregojnë se në krahasim me procesin e përgatitjes së buxhetit në vitin 2012, gjatëprocesit të përgatitjes së buxhetit për vitin 2013 është shënuar rritje e numrit të takimeve publike me qytetarë.⁵⁴ Ndarja e buxhetit ka qenë e drejtë⁵⁵, por opozita e mohon këtë dhe si shkak e konsideron nepotizmin. Një shumë prej 1,060,000€ është ndarë në kodin buxhetor për zyrën e Kryetarit të Komunës dhe është orientuar në projekte jo praktike për të cilat nuk ka asnjë raport në lidhje me mënyrën e shpenzimit. Nuk janë caktuar kritere për ndarjet buxhetore dhe për pasojë buxheti nuk është ndarë në mënyrë të drejtë.⁵⁶

Kodi i Zyrës së Kryetarit të Komunës (nënkryetarit, zyrës së informimit, prokurimit dhe auditimit) përbëhet nga dy kode, njëri për bashkëfinancim me donatorët dhe ministritë, dhe tjetri për shpronësim. Drejtori për Buxhet dhe Financa pohon se kodi buxhetor për Zyrën e Kryetarit të Komunës ndahet me qëllim të ndarjes së mjeteve për investime apo bashkëfinancim të projekteve me organizata apo institucione tjera, kur këto mjete nuk janë në dispozicion dhe nuk janë zotuar për periudhën në fjalë (zotimi i mjeteve për investime kapitale përfundon javën e parë të Nëntorit). Në një rast në Nëntor të vitit 2008, USAID kishte treguar gatishmëri për të negociuar marrëveshjen për bashkëfinancimin e një projekti me komunën, por kjo nuk ka qenë e mundshme për shkak se nuk ka pasur mjete në dispozicion. Andaj, për këtë arsye nga viti 2009 është krijuar kodi buxhetor për Zyrën e Kryetarit të Komunës.⁵⁷ Përfaqësuesit e opozitës theksojnë se investimet kapitale nuk janë planifikuar dhe ndarë si duhet, dhe se shumica e rrugëve janë ndërtuar në vendbanimet ku jetojnë elektorati i AAK-së. Shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë tejkaluara në krahasim me buxhetin e ndarë, dhe kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në kategorinë e investimeve kapitale prej nga janë transferuar mjetet për të mbuluar shpenzimet e tejkaluara në mallra dhe shërbime.⁵⁸ Buxheti i komunës ishte

51 Grapci, A. "Procesi buxhetor në komunën e Pejës". [Intervistë] 16 Dhjetor, 2013

52 Ibid

53 Sheremeti, D. "Budgeting process in the Municipality of Peja". [Intervieë] 16 December 2013

54 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Procesi i Zhvillimit të Buxhetit Komunal në Kosovë: Vlerësim i përgjithshëm për vitet 2012-2013. Qasur me 30 Januar 2013, <http://www.osce.org/kosovo/102215>

55 Grapci, A. "Procesi buxhetor në komunën e Pejës". [Intervistë] 16 Dhjetor, 2013

56 Sheremeti, D. "Procesi buxhetor në komunën e Pejës". [Intervistë] 16 Dhjetor, 2013

57 Grapci, A. "Procesi buxhetor në komunën e Pejës". [Intervistë] 16 Dhjetor, 2013

58 Sheremeti, D. "Procesi buxhetor në komunën e Pejës". [Intervistë] 16 Dhjetor, 2013

miratuar nga Kuvendi Komunal me shumicën e thjeshtë, por ishte kundërshtuar nga opozita.⁵⁹ Mbikëqyrja e ekzekutimit të buxhetit bëhet përmes Kuvendit Komunal në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Sipas përfaqësuesve të opozitës ka pasur raste kur vendimet janë marrë pa miratimin e Kuvendit Komunal, siç ka qenë rasti në disa shpronësime.⁶⁰

Auditimi i brendshëm në komunën e Pejës është kryer, por përfaqësuesit e opozitës asnjëherë nuk kanë pranuar ndonjë raport nga zyra e auditorit të brendshëm. Gjithashtu, komuna përgatit raporte tremujore dhe vjetore të shpenzimeve të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave dhe pastaj publikohen.⁶¹ Përfaqësuesit e opozitës pohojnë se raportet të cilat dorëzohen në Ministri dallojnë nga raportet të cilat i dorëzohen Kuvendit Komunal dhe se është vështirë të sigurohet qasje në raporte ngase shumica prej tyre nuk publikohen. Raportet nuk publikohen me qëllim që të mos bëhen publike kontratat të cilat janë dhënë në bazë të nepotizmit.⁶² Për raportimet dhe problemet me transparencën, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka konstatuar se raportet e auditimit të brendshëm kanë qenë të paqarta dhe jo cilësore.⁶³

Komuna e Gjilanit

Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit zhvillohet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj. Plani zhvillimor i komunës dhe prioritetet në të janë caktuar në bazë të nevojave dhe kërkesave që kanë parashtruar qytetarët gjatë takimeve publike. Prioritetet kryesore për komunën e Gjilanit përfshijnë planifikimin urban, infrastrukturën, mirëmbajtjen e rrugëve dhe ndriçimin.⁶⁴

Gjatë takimeve publike të mbajtura në vitin 2012 numri i pjesëmarrësve nuk ka qenë i mjaftueshëm, dhe më i vogël ka qenë numri i qytetarëve të zakonshëm se i zyrtarëve të komunës dhe partisë në pushtet. Komuna ka shpallur njoftimin për organizimin e takimeve publike dy javë më herët, por për buxhetin e vitit 2012 dhe atë të vitit 2013 janë organizuar vetëm nga dy takime publike me qytetarë.⁶⁵ As përfaqësuesit e partisë në pushtet dhe as ata të partive opozitare nuk kanë qenë të kënaqur me nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto takime.⁶⁶ Qytetarët vlerësojnë se shqetësimet e tyre nuk do të merren parasysh, prandaj edhe preferojnë mos të marrin pjesë në këto takime.⁶⁷ Kërkesat e qytetarëve kryesisht kanë të bëjnë me infrastrukturën, kanalizimin, ujin e pijshëm dhe arsimin. Për shkak të buxhetit të vogël komuna nuk ka pasur mundësi të adresoj të gjitha

59 Sheremeti, D. "Procesi buxhetor në komunën e Pejës". [Intervistë] 16 Dhjetor, 2013

60 Sheremeti, D. "Procesi buxhetor në komunën e Pejës". [Intervistë] 16 Dhjetor, 2013

61 Grapci, A. "Procesi buxhetor në komunën e Pejës". [Intervistë] 16 Dhjetor, 2013

62 Sheremeti, D. "Procesi buxhetor në komunën e Pejës". [Intervistë] 16 Dhjetor, 2013

63 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i auditimit për deklaratat financiare të komunës së Pejës. 31 Dhjetor, 2012. Qasur me 30 Janar 2014 2014.

http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPE_2012_Eng_299944.pdf

64 Nuhiu, N. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013; Maliqi, Z. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

65 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Procesi i Zhvillimit të Buxhetit Komunal në Kosovë: Vlerësim i përgjithshëm për vitet 2012-2013. Qasur me 30 Janar 2013, <http://www.osce.org/kosovo/102215>

66 Nuhiu, N. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013; Maliqi, Z. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

67 Nuhiu, N. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

këto probleme. Një shqetësim tjetër i vazhdueshëm mbetet edhe cilësia e investimeve dhe vonesat në realizimin e projekteve.⁶⁸ Vonesat janë shkaktuar si pasojë e mungesës së fondeve dhe situatave ku kompanitë janë kontraktuar pa pasur mjete financiare të zotuara, duke shkaktuar kështu deficit buxhetor dhe borxhe.⁶⁹ Vonesat në realizimin projekteve janë vërtetuar edhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.⁷⁰ Në lidhje me këtë çështje Drejtori i Buxhetit dhe Financave thekson se kontratat pa mjete të zotuata paraprakisht janë nënshkruar vetëm për disa projekte me vlerë të vogël.⁷¹

Sa i përket ndarjeve buxhetore, edhe pozita edhe opozita pajtohen se buxheti është i vogël për të përballur kërkesat e qytetarëve andaj ato mund të adresohen vetëm pjesërisht. Megjithatë, buxheti i Gjilanit për kokë banori në vitin 2012 ka qenë më i madh se katër komunat tjera (vetëm Prishtina ka buxhet më të lartë për kokë banori). Përfaqësuesit e opozitës pohojnë se buxheti nuk është ndarë në mënyrë të drejtë dhe se orientimi i tij është influencuar nga partia në pushtet, dhe është bërë në bazë të nepotizmit. Në disa lagje nuk ka fare investime ndërsa në lagje të tjera realizohen projekte të ndryshme.⁷² Në institucionet e komunës nuk ka këshilltarë profesionalist në fusha të caktuara dhe nëse do të ishin 2-3 ekspertë për secilën fushë atëherë situata në komunë do të ishte më e mirë.⁷³ Buxheti i komunës është miratuar me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Kuvendit Komunal, ndërkohë që përfaqësuesit e opozitës kanë marrë pjesë në mbledhje por nuk kanë votuar. Ekzekutimi i buxhetit mbikëqyret nga Zyrtari Kryesor Financiar, dhe procedurat e shpenzimit të buxhetit janë në përputhje me rregulloret e komunës për financa.⁷⁴ Megjithatë, në disa raste këto rregullore janë shkelur, siç ishte rasti i mbulimit të pagave nga mjetet e planifikuara në kuadër të kategorisë për mallra dhe shërbime.⁷⁵ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka gjetur edhe raste kur shpenzimet në kategorinë për mallra dhe shërbime janë mbuluar nga mjetet e transferuara nga kategoria për investime kapitale, duke shkelur kështu dispozitat e Ligjit për Buxhetin dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike.⁷⁶

Sa i përket auditimit të brendshëm dhe raporteve të shpenzimeve, mund të thuhet se auditimi i brendshëm bëhet rregullisht në baza vjetore dhe raportet vihen në dispozicion të publikut përmes faqes zyrtare në internet. Gjithashtu, përfaqësuesit e opozitës mund të kenë qasje në raporte dhe dokumente të tjera sa herë që kërkojnë një gjë të tillë.⁷⁷

68 Nuhiu, N. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013; Maliqi, Z. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

69 Maliqi, Z. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

70 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i auditimit për deklaratat financiare të komunës së Gjilanit. 31 Dhjetor, 2012. Qasur me 30 Janar 2014 2014.

http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGL_2012_Eng_132353.pdf

71 Nuhiu, N. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

72 Nuhiu, N. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013; Maliqi, Z. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

73 Nuhiu, N. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

74 Nuhiu, N. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013; Maliqi, Z. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

75 Maliqi, Z. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

76 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raporti i auditimit për deklaratat financiare të komunës së Gjilanit. 31 Dhjetor, 2012. Qasur me 30 Janar 2014 2014.

http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGL_2012_Eng_132353.pdf

77 Nuhiu, N. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013; Maliqi, Z. "Procesi buxhetor në komunën e Gjilanit". [Intervistë] 27 Dhjetor, 2013

Komuna e Ferizajit

Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit zhvillohet në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara me ligj. Përfaqësuesit e opozitës pohojnë se ata nuk kanë qenë të ftuar të përfshihen në këtë proces.⁷⁸ Edhe pse në të gjitha komunat buxheti përgatitet në përputhje me prioritetet e përcaktuara me Planin Strategjik Zhvillimor, komuna e Ferizajit nuk ka një plan të tillë. Zyrtares kryesor Financiar pohon se plani zhvillimor është përgatitur por nuk është miratuar ende. Prioritetet buxhetore në komunën e Ferizajit janë përcaktuar në bazë të nevojave të qytetarëve të shpalosura gjatë takimeve publike dhe sipas rëndësisë për secilin sektor.⁷⁹ Megjithatë, përfaqësues të opozitës vlerësojnë se prioritetet buxhetore janë përcaktuar në bazë të nevojave dhe kërkesave të partisë në pushtet (PDK). Prioritetet buxhetore janë të përqendruara në infrastrukturë (uji i pijshëm, kanalizimi dhe ndërtimi i rrugëve), shëndetësi (ndërtimi i spitalit), arsim (ndërtimi i shkollave), bujqësi dhe kulturë.⁸⁰ Siç u theksua më lartë, gjatë procesit buxhetor zhvillohen takime me qytetarë me qëllim që të parashtrihen kërkesat dhe shqetësimet e tyre. Në vitin 2012 komuna e Ferizajit kishte organizuar më së shumti takime publike me qytetarë, ndërsa gjatë vitit 2013 janë realizuar pesë takime publike, e që në krahasim me komunat tjera është numër relativisht i lartë.⁸¹ Përfaqësues të opozitës dhe të opozitës ankohen për numrin e vogël të pjesëmarrësve, veçanërisht në dy takimet e fundit publike.⁸² Edhe pse të paktë në numër, qytetarët që kanë marrë pjesë në takimet publike si shqetësim kryesor kanë pasur ndërtimin e rrugës për Gjilan, ku për shkak të punimeve mbi 500 biznese që veprojnë në këtë zonë janë obliguar të ndërprejnë punën.⁸³

Ndarja e buxhetit pasqyron në masë të madhe nevojat e qytetarëve, ndërkohë që në radhët e opozitës vlerësohet se partia në pushtet e orienton buxhetin drejt zonave ku është i përqendruar elektorati i saj. Në disa raste komuna ndanë subvencione për drejtorët e drejtorive dhe dokumentacioni përkatës për këto raste nuk i vihet në dispozicion opozitës apo qytetarëve.⁸⁴ Mungesa e dokumenteve mbështetëse dhe mos respektimi i procedurave për ndarjen e subvencioneve janë evidentuar edhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.⁸⁵

Buxheti i komunës është miratuar me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit Komunal. Përfaqësuesit e opozitës kanë qenë të pranishëm në mbledhjen kur është shqyrtuar dhe miratuar buxheti, por ata nuk e kanë mbështetur atë sepse asnjë nga sugjerimet e tyre nuk është përfshirë në buxhet. Ekzekutimi i buxhetit mbikëqyret nga departamenti i thesarit.⁸⁶ Në këtë drejtim, janë vërejtur raste kur komuna ka nënshkruar kontrata me operatorë lokal pa pasur mjetet e nevojshme financiare të zotuar, dhe shumë projekte kanë nisur pa qenë të përfshira paraprakisht në buxhet. Si pjesë e marrëveshjes

78 Guri, F. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

79 Brahimi, M. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

80 Guri, F. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

81 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Procesi i Zhvillimit të Buxhetit Komunal në Kosovë: Vlerësim i përgjithshëm për vitet 2012-2013. Qasur me 30 Januar 2013, <http://www.osce.org/kosovo/102215>

82 Brahimi, M. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

83 Guri, F. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

84 Guri, F. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

85 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i auditimit për deklaratat financiare të komunës së Gjilanit. 31 Dhjetor, 2012. Qasur me 30 Janar 2014 2014, http://www.oag-rks.org/repository/docs/Ferizaj_163570.pdf

86 Brahimi, M. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

për bashkëfinancimin e një projekti me Caritasin, parashihej edhe punësimi i zyrtarëve shtesë për realizimin e projektit. Punësimi për këtë projekt nga ana e Komunës është bërë pa konkurs.⁸⁷ Menaxhimi jo adekuat i buxhetit ka shkaktuar deficit apo suficit. Komuna është përballur me deficit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, dhe shpenzimet shtesë janë mbuluar nga të hyrat që komuna ka arritur të siguroj gjatë vitit.⁸⁸

Auditimi i brendshëm është shumë i rëndësishëm në mënyrë që institucionet e komunës të punojnë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe rekomandimet. Deri vonë komuna ka pasur vetëm një auditor të brendshëm, por me rekomandim të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë punësuar edhe dy auditor të tjerë. Përfaqësues të opozitës theksojnë se një nga të punësuarit në postin e auditorit të brendshëm ka të përfunduar fakultetin e Kriminologjisë, gjë që paraqet shkelje të dispozitave të ligjit. Auditorët e brendshëm kryejnë auditimin rregullisht dhe raportin me rekomandime e dorëzojnë te Kryetari i Komunës, i cili më pas merr masat e nevojshme. Sa i përket qasjes në raportet e auditimit dhe raportet e shpenzimeve, përfaqësues të pozitës dhe opozitës kanë qëndrime të ndryshme. Derisa Zyrtari Kryesor Financiar thekson se raportet në fjalë janë të postuar të faqen zyrtare në internet,⁸⁹ përfaqësues të opozitës pohojnë se ato raporte nuk janë publikuar me gjithë insistimin e tyre.⁹⁰ Megjithatë, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka vlerësuar pozitivisht punën e auditorëve të komunës së Ferizajit.⁹¹

Komuna e Prishtinës

Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës zhvillohet ngjashëm si në komunat tjera. Plani zhvillimor i komunës është miratuar vitin e kaluar, dhe në kuadër të tij përfshihet plani për zhvillim urban dhe zhvillim komunal. Prioritet e përcaktuara në këtë plan përputhen me prioritetet buxhetore, të cilat janë të orientuara kryesisht në fushën e infrastrukturës (rrugët, furnizimi me ujë, kanalizimi), arsimit (shkollat, çerdhet, etj.) dhe shëndetësia (ambulancat).⁹² Edhe pse përcaktimi i prioritetëve bëhet nga Kryetari i Komunës në konsultim me Bordin Këshilldhënës, në shumicën e rasteve Kryetari nuk ka marrë pjesë në takimet e bordit.⁹³ Prioritetet e lartpërmendura janë përcaktuar në bazë të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve të parashtruara në pesë takimet publike të organizuara gjatë vitit 2012. Gjatë këtyre takimeve qytetarët kanë ngritur shumë shqetësime dhe kërkesa, por për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm jo të gjitha kanë mundur të adresohen.⁹⁴ Opozita (VV) vlerëson se prioritetet buxhetore nuk përputhen me kërkesat që janë parashtruar nga qytetarët, qytetarët nuk janë njoftuar si duhet për mbajtjen e takimeve publike, dhe për pasojë numri i pjesëmarrësve ka qenë shumë i vogël dhe kryesisht i përbërë nga elektorati i partisë në pushtet (LDK).⁹⁵ Të gjeturat e OSBE tregojnë se sa i përket procesit buxhetor për vitet 2012-2013, komuna e Prishtinës ka shpallur njoftimet

87 Guri, F. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

88 Brahimi, M. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

89 Brahimi, M. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

90 Guri, F. "Procesi buxhetor në komunën e Ferizajit". [Intervistë] 20 Dhjetor, 2013

91 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raporti i auditimit për deklaratat financiare të komunës së Ferizajit. 31 Dhjetor, 2012. Qasur me 30 Janar 2014, http://www.oag-rks.org/repository/docs/Ferizaj_163570.pdf

92 Bektashi, Xh. "Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës". [Intervistë] 13 Janar, 2014

93 Bislimi, B. "Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës". [Intervistë] 02 Dhjetor, 2013

94 Bektashi, Xh. "Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës". [Intervistë] 13 Janar, 2014

95 Bislimi, B. "Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës". [Intervistë] 02 Dhjetor, 2013

për mbledhjet e organeve legjislativë së pakur shatë ditë para takimit, siç përcaktohet me ligj.⁹⁶ Shqetësimet kryesore të qytetarëve kishin të bëjnë me furnizimin me ujë dhe kanalizimin,⁹⁷ dëmtimin e vlerave arkitektonike dhe vërshimet në disa lagje. Megjithatë, këto shqetësime nuk janë marrë parasysh.⁹⁸

Sa i përket ndarjeve buxhetore, buxheti është shumë i vogël në krahasim me kërkesat e qytetarëve dhe komuna është menduar të siguroj ndarje sa më të drejtë në përputhje me nevojat e tyre.⁹⁹ Buxheti i komunës së Prishtinës për kokë banori është më i larti në krahasim me pesë komunat tjera. Megjithatë, duke qenë kryeqytet Prishtina përballlet me numër të madh të njerëzve që jetojnë përkohësisht aty, ose që qëndrojnë gjatë ditës. Edhe pse nuk janë të regjistruar si banorë të Prishtinës ata shkaktojnë shpenzime shtesë për shërbimet publike komunale. Në bazë të dhënave të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, rreth 56.000 njerëz qëndrojnë gjatë ditës në qytetin e Prishtinës.¹⁰⁰ Nëse vetëm ky grup i njerëzve që shfrytëzon pjesërisht shërbimet publike që ofron qyteti i Prishtinës numërohet si pjesë e popullsisë atëherë buxheti për kokë banori do të shënonte rënie prej 21%. Siç u theksua më lartë ekziston edhe një numër i njerëzve të cilët jetojnë në Prishtinë gjatë ditëve të punës, por ende nuk ka të dhëna për numrin e tyre. Në anën tjetër përfaqësues të opozitës vlerësojnë se buxheti nuk është ndarë në mënyrë të drejtë dhe se partia në pushtet (LDK) e ka orientuar buxhetin drejt zonave ku jetojnë mbështetësit e kësaj partie.¹⁰¹ Buxheti është miratuar me shumicën e thjeshtë të votave dhe opozita ka qëndruar në mbledhje. Procedurat e ekzekutimit të buxhetit për secilin projekt mbikëqyren nga organet kompetente përkatëse. Megjithatë, në procedurat e tenderimit ka pasur shumë parregullsi ngase kushtet e tenderimit i janë përshtatur ofertuesve të caktuar.¹⁰²

Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm paraqesin një element të rëndësishëm me qëllim që të sigurohet transparencë dhe efikasitet në punën e komunës. Gjatë vitit kryhen auditime të brendshme dhe të jashtëmemegjithatë. raportet nuk ishin publikuar p.sh. në ueb-faqe.¹⁰³

96 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Procesi i Zhvillimit të Buxhetit Komunal në Kosovë: Vlerësim i përgjithshëm për vitet 2012-2013. Qasur me 30 Janar 2013, <http://www.osce.org/kosovo/102215>

97 Bektashi, Xh. "Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës". [Intervistë] 13 Janar, 2014

98 Bislimi, B. "Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës". [Intervistë] 2 Dhjetor, 2013

99 Bektashi, Xh. "Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës". [Intervistë] 13 Janar, 2014

100 Agjencioni i Kosovës për Statistika. Atlasi i regjistrimit të popullsisë. Qasur me 30 janar, 2014., http://esk.rks-gov.net/ENG/pop/publications/doc_vieë/1125-kosovo-census-atlas-?tmpl=component&format=raw

101 Bislimi, B. "Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës". [Intervistë] 2 Dhjetor, 2013

102 Bislimi, B. "Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës". [Intervistë] 2 Dhjetor, 2013

103 Bislimi, B. "Procesi buxhetor në komunën e Prishtinës". [Intervistë] 2 Dhjetor, 2013

VI. Transparenca

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Kryetari i Komunës është drejtpërdrejt përgjegjës për publikimin e raporteve financiare. Neni 45.4 specifikon se jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tremujorit, Kryetari i Komunës është i obliguar të publikoj raportet tremujore në faqen zyrtare të komunës në internet.¹⁰⁴ Tabela në vijim tregon raportet financiare tremujore dhe dokumentet tjera të cilat publikohen nga secila komunë. Duhet theksuar se ne nuk kemi hulumtuar në linqe të tjera të internetit, përveç atyre zyrtare të komunës. Ky link gjendet duke klikuar në “Pasqyrat dhe Planet Komunale” në versionin shqip të ueb-faqeve të secilës komunë. Siç tregojnë të dhënat në tabelën e mëposhtme, asnjë nga komunat nuk ka publikuar rregullisht raportet tremujore financiare, siç parashihet me ligj. Për më tepër, në faqen zyrtare të komunës së Prishtinës dhe Pejës në internet nuk është publikuar asnjë raport. Komuna e Ferizajit prin me numrin më të madh të raporteve financiare të publikuara, por as në këtë komunë nuk janë përmbushur obligimet siç parashihet me ligj.

104 Ligji nr. 03/L- 048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Qasur me 31 Januar 2014, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L048_en.pdf

Tabela 8. Dokumentet e publikuara sipas komunës

Dokumenti	Prishtina												Gjilani												Podujeva											
	2010				2011				2012				2010				2011				2012				2010				2011				2012			
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
Raportet tremujore financiare	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x			x	x	x	
Planifikimi buxhetor	x				x				x												x				x								x			
Rregullorja për tarifa gjoba dhe ngarkesa tjera																																				
Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal																																				
Plani Zhvillimor i Komunës																									x											

Dokumenti	Gjakova												Peja												Ferizaj											
	2010				2011				2012				2010				2011				2012				2010				2011				2012			
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
Raportet tremujore financiare	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x		x		x		x		x		x	
Planifikimi buxhetor	x								x				x				x																			
Rregullorja për tarifa gjoba dhe ngarkesa tjera																									x											
Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal																									x											
Plani Zhvillimor i Komunës																									x											

dokumenti është publikuar

x dokumenti nuk është publikuar

VII. Rekomandime të politikave

1. Buxheti komunal duhet të planifikohet, hartohet dhe zhvillohet në atë mënyrë që të mbuloj të gjitha kërkesat dhe prioritetet e përcaktuara me planin zhvillimor, të mbuloj të gjitha zonat gjeografike dhe të evitoj suficitin apo deficitin në fund të vitit. Siç është konstatuar me këtë analizë politikash, planifikimi dhe ndarja e buxhetit në asnjë rast nuk mbulon nevojat dhe kërkesat e të gjithë qytetarëve dhe zonave të caktuara gjeografike, dhe siç vlerësohet edhe nga përfaqësuesit e opozitës në secilën komunë, partitë në pushtet sigurohen që buxheti të orientohet drejt zonave ku jetojnë mbështetësit e partisë apo në bazë të preferencave të zyrtarëve të caktuar komunal. Andaj, është me rëndësi kritike që të ketë ndarje të drejtë të buxhetit në të gjitha komunat, dhe që adreson nevojat e kërkesat e të gjithë qytetarëve dhe jo vetëm të mbështetësve të partisë në pushtet apo lagjeve të caktuara. Ndarjet buxhetore duhet të synojnë ti shërbejnë të mirës së përgjithshme dhe jo interesave individuale apo të partive të caktuara.
2. Kjo analizë vë në pah edhe faktin se në shumë komuna të Republikës së Kosovës, për kryerjen e projekteve të caktuara angazhohet kompani të ndryshme pa përfillur kriteret e përcaktuara me ligj, dhe kur kësaj i shtohet fakti se mbikëqyrja e punës së tyre nuk bëhet si duhet, atëherë ka vonesa në kryerjen e punëve dhe cilësia e investimeve nuk është e mirë. Për të shmangur këto situata kur paraja publike shpenzohet në projekte të dështuara apo jo të duhura, për të evituar vonesat dhe për të siguruar investime cilësore, të gjitha komunat duhet të respektojnë rregullat, procedurat dhe kriteret e përcaktuara me ligj gjatë përzgjedhjes së kompanive për investime të tilla, dhe më pas të mbikëqyrin me kujdes realizimin e punimeve deri në fund të projektit.
3. Në shumicën e komunave janë nënshkruar kontrata për realizimin e projekteve pa pasur fondet e zotuar, duke shkaktuar kështu deficit buxhetor dhe borxhe. Me gjithë vërejtjet dhe rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm kjo praktikë ka vazhduar dhe nga viti në vit borxhi është rritur. Andaj, është e rëndësishme që këto kontrata të evitohen, të respektohen dispozitat e ligjit dhe të parandalohet rritja e mëtutjeshme e borxheve.
4. Siç u potencua në këtë analizë por edhe në raportet e Auditorit të Përgjithshëm, jo të gjitha komunat kanë respektuar kriteret ligjore dhe meritokracinë në punësimin e stafit. Ky problem duhet trajtuar me kujdes nga zyrtarët komunal, dhe të sigurohet që komuna të respektoj ligjet dhe rregulloret në fuqi me qëllim që të evitoj punësimin e individëve jokompetent që nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbime cilësore për komunën dhe qytetarët.
5. Ligji parasheh që komunat dhe të gjitha organizatat tjera buxhetore ti nënshtrohen auditimit të jashtëm. Andaj, rekomandimet e raporteve vjetore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm duhet të adresohen me përpikmëri nga të gjitha komunat, në mënyrë që evitohet keqmenaxhimi, zvarritja e problemeve dhe mosefikasiteti i komunës.
6. Ligji parasheh që çdo organizatë buxhetore me buxhet më të madh se pesë (5) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë të brendshëm, dhe siç është potencuar në këtë

analizë, jo të gjitha komunat kanë respektuar këtë obligim ligjor. Andaj, është shumë e rëndësishme që komunat të zbatojnë dispozitat e ligjit dhe të fuqizojnë njësitë për auditim të brendshëm, ngase rekomandimet e auditorëve të brendshëm ndihmojnë në rritjet e efikasitetit të punës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrohen për qytetarët.

7. Të gjitha raportet financiare që parashihen me ligj, si ato tremujore, gjashtëmujore, dhe vjetore për të hyrat dhe shpenzimet si dhe raportet nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm duhet të vihen në dispozicion të publikut. Të gjitha këto raporte duhet të publikohen në faqet zyrtare të komunave në internet. Kjo ndikon në rritjen e transparencës dhe besimit në mesin e individëve dhe partisë që udhëheq me komunën.
8. Për adresimin e nevojave, kërkesave dhe shqetësimeve, është me rëndësi esenciale që në procesin e përgatitjes së buxhetit të përfshihen të gjitha palët si: zyrtarët qeveritarë, punonjësit e komunës dhe para së gjithash qytetarët. Kjo ndihmon në vendimmarrje më të mirë, përmirësimin e perceptimit të qytetarëve për institucionet e shtetit dhe mundëson një pasqyrim më të drejtë të nevojave, kërkesave dhe shqetësimeve të të gjitha palëve.
9. Pothuajse në të gjitha komunat pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e përgatitjes së buxhetit ka qenë e ulët. Duke qenë një element shumë i rëndësishëm në përgatitjen e buxhetit, komunat duhet të bëjnë më shumë për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve. Në vijim mund të gjeni disa nga mekanizmat që komunat mund të vënë në zbatim për të zgjuar interesimin e qytetarëve që të marrin pjesë në procesin buxhetor.
 - *Fokus grupet* - paraqesin një formë të përfshirjes së grupeve të vogla të qytetarëve, duke u ofruar mundësinë që të shpalosin idetë, shqetësimet, kërkesat dhe preferencat e tyre në lidhje me buxhetin dhe çështjet tjera. Në këtë formë pjesëmarrësit mund të ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të arrijnë të gjejnë zgjidhje më cilësore për shqetësimet e tyre.
 - *Takimet në komunitet* - këto takime janë lehtë të menaxhueshme dhe përfshijnë grupe të qytetarëve nga zona të caktuara, apo të komunitetit të biznesit, me ç'rast kanë mundësi të shprehin shqetësimet dhe kërkesat e tyre për zonën ku jetojnë apo biznesin të cilin drejtojnë. Kjo u ndihmon zyrtarëve të komunës të kuptojnë më mirë nevojat dhe të ndajnë drejt buxhetin e komunës.
 - *Simulimet buxhetore* - në kohën kur komunat përballen me buxhet të kufizuar, pjesëmarrja e qytetarëve ndihmon në arritjen e marrëveshjeve rreth balancimit të kërkesave buxhetore dhe përcaktimit të prioritetëve që kërkojnë intervenim të menjëhershëm.
 - *Komisioni Këshillëdhënës i Qytetarëve për buxhet* - për të trajtuar nevojat e grupeve të caktuara të qytetarëve dhe për të ofruar rekomandime të dobishme në lidhje me buxhetin komunal mund të formohen edhe komisione këshillëdhënëse të qytetarëve për buxhet.
 - *Anketat me qytetarë* - kjo është një formë tjetër e mbledhjes së informacioneve dhe të dhënave për nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Zyrtarët komunal duhet

të përgatisin anketa të cilat krijojnë mundësinë për qytetarët që të shprehin shqetësimet dhe kërkesat e tyre por edhe të vlerësojnë punën e komunës në ndarjet buxhetore. Kjo ndihmon komunat që të identifikojnë zbrazëtitë e krijuara në terren dhe ti adresojnë ato në planifikimin e buxhetit për vitet në vijim.

- *Platformat online* – komunat duhet të themelojnë platforma online, ku qytetarët e komunave përkatëse mund të shprehin shqetësimet, idetë dhe sugjerimet e tyre. Kontributi i qytetarëve në këtë platformë mund të grumbullohet dhe të analizohet në baza vjetore, me qëllim që të shërbejë gjatë planifikimit të buxhetit, dhe orientimit të buxhetit drejt realizimit të projekteve dhe programeve të sugjeruara nga qytetarët.

Dhe në fund, secila komunë duhet të jetë në gjendje të identifikoj mekanizmat që i konsiderojnë më adekuat për komunat e tyre dhe të nisin menjëherë implementimin e tyre.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

Grupi për Studime Juridike dhe Politike është institut për studimin e politikave publike, i pavarur, jo-partiak dhe jo-fitimprurës me seli në Prishtinë, Kosovë. Misioni ynë është që të zhvillojmë studime kredibile në fushën e politikës, së drejtës, dhe ekonomisë, si dhe të ofrojmë rekomandime politikash që mëtojnë të zgjidhin problemet në fushat e caktuara të politikave.

